



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 24, QARKU DURREËS, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 10.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 24, Qarku Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa "a", neni 93 dhe 94, pika 1 e ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1564 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Durrës, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Durrës që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për gjashtë (6) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Durrës, me shkresën nr. 2489 prot, datë 23.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për seicilën nga VNV-të e Qarkut Durrës.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr. 24, Qarku Durrës, është:



**Nr.287 i Vendimit    Data 10.05.2019 e Vendimit    Ora 11.00 e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.24, Qarku Durrës,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

1. Palestra e shkollës së mesme sportive "Bernadina Qeraxhia", Durrës, me sipërfaqe rreth 500 m<sup>2</sup>;

Ky ambient ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet e 2017, ndodhet brenda Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 24, Qarku Durrës, në Palestra e shkollës së mesme sportive "Bernadina Qeraxhia", Bashkia Durrës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI</b>	-	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA</b>	-	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERAJ</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI</b>	-	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	-	<b>Anëtare</b>



**Nr.287 i Vendimit    Data 10.05.2019 e Vendimit    Ora 11.00 e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.24, Qarku Durrës,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019